

AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Balkan Paradise” SH.P.K.

THEMELIMI
NENI 1
ORTAKËT THEMELUES

Sot, më datën 14 Korrik 2022, ne, ortakët themelues, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **“Balkan Paradise” SH.P.K.**

Themeluesi i shoqërisë:

Salaheldin Hamed Noureldin Moussa, dt.lindje 01.02.1991, me pasaportë nr. A28327002, lindur në Egjipt, me shtetësi egjiptiane, banues në Egjipt.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA JURIDIKE, OBJEKTI

NENI 2
EMËRTIMI

Shoqëria emërohet: **“Balkan Paradise” SH.P.K.**

NENI 3
FORMA LIGJORE

Shoqëria do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas sanksionimeve të ligjit “Për Shoqëritë Tregtare”.

Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër, nëse miratohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4
PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, si dhe me legjislacionin shqiptar.

NENI 5
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë, Rr. “Besa”, nr. 3, k. 2, njesia bashkiake nr. 8.

Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra përfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Faqja zyrtare Web e Shoqërisë do të jetë www. .al



NENI 6
EMBLEMA/VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Këshilli Administrativ ose Administratori, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 7
OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e:

Turizmit, guida turistike, agjensi turistike, prenotim dhe bileta të guidave dhe udhëtime turistike në Shqipëri dhe jashtë saj, veprimtari të ndryshme në përmbushje të aktivitetit dhe qëllimit të shoqërisë, airbnb, pasurisë së paluajtshme, regjistrimit të studentëve të huaj në universitetet e vendit, shërbimeve të ndryshme ndaj investitorëve të huaj.

KOHËZGJATJA/KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 8
KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të papërcaktuar.

NENI 9
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë “**Balkan Paradise**” SH.P.K. është 100000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100000 (njëqindmijë) lekë.

Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon: **Salaheldin Hamed Noureldin Moussa** zotëron 1 kuotë baraz me 100% të kapitalit, pra 1 kuotë me vlerë 100000 lekë.

NENI 10
TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPTITALIT THEMELTAR

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë të trashëgueshme.

Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore midis bashkëshortëve, si edhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Personi që fiton të drejta mbi një kuotë, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR. Për transferimin e kuotave të kapitalit themeltar midis ortakëve do të respektohet e drejta e parablerjes midis ortakëve, dhe në rast të transferimit të kuotave tek të tretët, duhet të kërkohet miratimi i shoqërisë.



NENI 11
KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR, në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se ai nuk është dakord me personin të cilit i kalon kuota.

Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranimin, personin të cilit i kalohet kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

NENI 12
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë do të jetë:

1- Salaheldin Hamed Noureldin Moussa

I cili emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve. Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratorit i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e tij në mbledhje, lidhur me përmbushjen e detyrave të tij. Administratori gëzon të drejtën të delegojë nëpërmjet një prokure të posaçme, disa nga kompetencat e tij.

NENI 13
MARRËVESHJET E NDALUARA

(1) Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë, nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdo lloj forme, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve.

(2) Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

(3) Kjo masë ndaluese zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.



NENI 14
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- (4) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dhënie të përfitimeve të tilla.
- (5) Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) përcaktimin e kushteve dhe rregullave për punësimin e personave të jashtëm sipas nevojave të Shoqërisë.
 - n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



NENI 15
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- (1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- (2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

NENI 16
TË DREJTAT E SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

- (1) Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të nënshkruajë marrëveshje brenda dhe jashtë vendit.
- (2) Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u përjashtuar përgjegjësia personale e çdo ortaku.
- (3) Ortakët përballojnë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- (4) Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment raportin e administrimit, inventarët, llogaritë vjetore, për tre vitet e fundit financiare, duke qenë i ndihmuar, po të jetë nevoja, nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional.
- (5) Një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 1/3 e kuotave të kapitalit, mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një eksperti për paraqitjen e një raporti për një ose disa vendime administrative.
- (6) Ortakët mund të caktojnë një përfaqësues ligjor për administrimin e çështjeve të veçanta ligjore, siç është p.sh. përfaqësimi në gjykatë etj. Honoraret vendosen në marrëveshje midis ortakëve dhe përfaqësuesit ligjor.

NENI 17
DETYRAT E ORTAKËVE

Ortakët detyrohen të depozitojnë kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak detyrohet të sigurojë në kohë dhe plotësisht detyrimet e tij ndaj shoqërisë dhe ortakëve të tjerë.

Kur ortaku nuk u përgjigjet detyrimeve, atëherë ortaku tjetër, pasi e ka njoftuar dhe ai nuk ka plotësuar detyrimin kërkon dëmshpërblimin.

NENI 18
VOTAT E ORTAKËVE

- (1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në



rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

- (2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- (3) Të gjitha votat e pa kundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

NENI 19 **VOTIMI ME PROKURË**

- (1) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

“Balkan Paradise” sh.p.k.

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 20.....".

- (2) Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):

“Balkan Paradise” sh.p.k.

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më, ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 *pro *kundër.

Vendimi Nr. 2 *pro *kundër.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme.

Nënshkruar më..... 20.....".

- (3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së



Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

- (4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email), ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

NENI 20 **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

Emërimi dhe shkarkimi

Shoqëria “**Balkan Paradise**” sh.p.k. mund të emërojë një ekspert kontabël të autorizuar.

Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

Shqyrtimet e bëra pa caktuar ekspert kontabël të autorizuar në rastet e detyruara me ligj si edhe raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, të emëruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në ligj janë të pavlefshme.

Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve për një periudhë të caktuar financiare, në rast gabimi ose pengimi, ekspert kontabël i autorizuar mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim gjykate.

Detyrat e ekspertit kontabël të autorizuar

Garanton që llogaritë vjetore janë të rregullta dhe të hartuara me sinqeritet konform ligjeve dhe jep një pasqyrim besnik të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar financiar si dhe të gjendjes financiare të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar.

Verifikon librat e llogarive dhe fondet e shoqërisë dhe kontrollon përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.

Verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit nga administratori përpara asamblesë së ortakëve si dhe në dokumentet që i janë dërguar asamblesë mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore.

Eksperti kontabël i autorizuar është i detyruar t'i bëjë të njohur administratorit dhe asamblesë së ortakëve.

- a) Kontrollat dhe verifikimet që ka kryer dhe sondazhet që ka bërë.
- b) Pjesët e bilancit dhe të dokumenteve të tjera të kontabilitetit në të cilat sipas tyre duhet të ishin bërë ndryshime duke bërë gjithashtu edhe të gjitha vërejtjet e duhura mbi metodat e vlerësimit të përdorur në përpilimin e këtyre dokumenteve.
- c) Parregullsitë dhe pasaktësitë që ka zbuluar.



d) Përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet e mësipërme mbi rezultatet e vitit financiar, të krahasuara me ato të vitit financiar të mëparshëm.

Eksperti kontabël i autorizuar thirret nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, kur shqyrtohet mbyllja e llogarive të vitit të kaluar financiar dhe sa herë kërkohet nga asambleja e ortakëve.

Përgjegjësitë ligjore të ekspertit kontabël

Eksperti kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvleftësimet në ushtrimin e funksionit të tij, por nuk është ligjërisht përgjegjës për shkeljet ligjore të kryera nga administratori me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk i ka zbuluar dhe raportuar ato asamblesë së ortakëve.

Honoraret e ekspertit kontabël

Honoraret e ekspertit kontabël të autorizuar paguhen nga shoqëria.

NENI 21 **DIVIDENTËT**

- (1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

NENI 22 **VITI FINANCIAR**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.



NENI 23
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqiptar.

NENI 24
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të kundërt, ortakët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku Shoqëria ka selinë, për zgjidhje.

NENI 25

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të bëhet referim në dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar në përgjithësi.

NENI 26

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“Balkan Paradise” sh.p.k.

Salaheldin Hamed Noureldin Moussa

Tiranë, më 14. 07. 2022

Perfaqesuar nga
Neveen Abdelkhalek

